



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

---

VËMENDJE: Ky nuk është dokument zyrtar i Komisionit Evropian. Është përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme bazuar në analizat dhe shembujt e udhërrëfyesëve të Shqipërisë, Bosnës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë. Ky dokument supozon se Republika e Kosovës ka lidhur Marrëveshjet për Ri-pranim dhe Lehtësim të Vizave me Komisionin Evropian në mënyrë që të hap rrugën për procesin e Liberalizimit të Vizave.

## **UDHËRRËFYES I LIBERALIZIMIT TË VIZAVE ME BASHKIMIN EUROPIAN**

### **I. HISTORIKU**

Ministria e Punëve të Brendshme në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka përgatitur dokumentin e udhërrëfyesit për t'ia paraqitur Zyrës Ndërlidhës me Komisionin Evropian në Kosovë. Ndonëse ky nuk është dokument zyrtar i Komisionit Evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës mendon se është e domosdoshme të përgatiten bazat e Marrëveshjes për Liberalizim të Vizave.

Duke pasur parasysh se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë inicuar apo madje janë duke finalizuar përgatitjet për marrëveshjen për liberalizim të vizave, Republika e Kosovës do të dëshironte të avanconte drejt liberalizimit të vizave duke përmbushur të gjitha kriteret e procesit. Duke mos lejuar Kosovën që të ketë një udhërrëfyes të definuar qartë për liberalizim të vizave, Komisioni Evropian rrezikon në izolimin e Kosovës, që do të paraqiste rrezik dhe do të destabilizonte më tej Kosovën dhe rajonin. Përveç kësaj, Republika e Kosovës aspiron në integrimin në BE, kështu që plani i punës dhe Marrëveshja për Liberalizimin e Vizave do të angazhonte Kosovën në mënyrë aktive në procesin e tillë.

## II. HYRJE – KORNIZA E PËRGJITHSHME

A. Këshilli për Punë të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme në konkluzionet e tij më 28 Janar 2008 mirëpriti synimin e Komisionit Evropian që të nisë dialogun për viza me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ka shprehur gatishmërinë e tij që të diskutohet më tej këtë çështje, bazuar në Komunikatën e Komisionit mbi Ballkanin Perëndimor, me synim të definimit të udhërrëfyesit (roadmap) në mënyrë të detajuar duke përcaktuar kuartet pikat që duhet të plotësohen nga të gjitha vendet në rajon në mënyrë që gradualisht të përparojmë drejt liberalizimit të vizave. I tërë procesi do të jetë për së afërmi i monitoruar nga Këshilli dhe Komisioni, që do të vlerësojnë progresin e vendeve përkatëse dhe përcjelljen e miratimit dhe implementimit të reformave të nevojshme në drejtim të heqjes së kërkesës (nevojës) për vizë.

Komisioni në mënyrë të rregullt do të raportojë mbi implementimin e këtij udhërrëfyesi në Këshill, duke filluar para fundit të vitit 2008, posaqërisht duke marrë parasysh inputet nga ekspertët, përfshirë ekspertët e Shteteve Anëtare, në kontekst të dialogut për viza.

B. Gjatë krijimit të metodologjisë për procesin e liberalizimit të vizave, elementet në vijim duhet të merren parasysh:

- perspektiva Evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor;
- përkushtimi politik i ndërmarr nga Bashkimi Evropian mbi liberalizimin e vizave afat-shkurta për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës së Selanikut, e cila është konfirmuar në nivel politik nga një seri e konkluzioneve të Këshillit që nga 2003;
- përfundimi nga të gjitha vendet në rajon të marrëveshjes për ri-pranim të Komunitetit;
- Lirimi nga viza i të gjithë qytetarëve të BE-së nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në vitin 2007, si hap i parë konkret drejt përmirësimit të kontakteve person me person, Komuniteti Evropian ka përfunduar Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Këto marrëveshje kanë hyrë në fuqi më 1 Janar 2008. Preambula e marrëveshjeve për lehtësim të vizave përfshin referencë të kuartet të përkushtimit të palëve për të punuar drejt sistemit të udhëtimit pa viza në të ardhmen.

C. Duke pasur parasysh gamën e gjërë të çështjeve relevante për dialogun e liberalizimit të vizave, qëllimi i këtij zhvillimi është identifikimi i të gjitha masave që do të miratohen dhe implementohen nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përcaktimi i kriteriumeve të kuartet që duhet të arrihen në të ardhmen e afërt. I tërë procesi do të ndahet në katër grupe çështjesh që do të mbulohen në dialog:

siguria e dokumenteve, migrimi ilegal, rendi dhe siguria publike, si dhe çështjet e marrëdhënieve të jashtme të lidhura me lëvizjen e njerëzve. Dialogu do të bëhet sipas porosisë në mënyrë që ti mundësohet secilit vend të fokusohet në përpjekje për reformim dhe të adreson kriteriumet e BE-së. Shpejtësia e avancimit drejt liberalizimit të vizave do të varet nga progresi i bërë nga secili vend përkatës në përmbushjen e kushteve të caktuara.

Lidhur me strukturën, i tërë dialogu si pjesë e politikës së përgjithshme të BE-së në drejtim të vendeve kandidate dhe vendeve potenciale kandidate të Ballkanit Perëndimor do të zhvillohet në kuadër të kornizës së strukturës së procesit të Stabilizimit dhe Asocimit. Procesi i liberalizimit të vizave do të bëhet nga zyrtarë të lartë të cilët do të mund të vendosnin për organizimin e takimeve teknike në nivel ekspertësh për çështje specifike. Raportimi mbi progresin e bërë mbi çështjet që mbulohen me anë të procesit për liberalizimin e vizave do të sigurohet në kuadër të kornizës së punës së strukturave relevante të marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit.

D. I tërë procesi do t'i mundëson Komisionit që të propozon në momentin e përshtatshëm Këshillit për heqjen e obligimit të vizës për qytetarët e Republikës së Kosovës, përmes një amandamenti në Rregulloren e Këshillit 539/2001. Në bazë të propozimit të Komisionit, Këshilli, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, do të vendos duke vepruar me shumicë të përshtatshme.

## **UDHËRRËFYESI DREJT SISTEMIT PA VIZA ME REPUBLIKËN E KOSOVËS**

### **I. Kriteriumet e ndërlidhura me implementimin e drejtë të Marrëveshjeve të Komunitetit për Lehtësim të Vizave dhe Ri-pranim**

#### **A. MARRËVESHJA PËR RI-PRANIM:**

Republika e Kosovës duhet të ndërmerr masa të duhura duke siguruar implementim efektiv të Marrëveshjes së Komunitetit për Ripranim dhe në veçanti, zëvendësimin e marrëveshjeve bilaterale të mëhershme apo aranzhimeve me marrëveshjen për ri-pranim të Komunitetit, përfundimin e 'protokoleve implementuese' me Shtetet Anëtare, miratimin e masave duke siguruar se infrastruktura e duhur është në vend, në veçanti stafi i mjaftueshëm, për trajtimin e aplikacioneve për ri-pranim, respektimin e afateve të ndryshme të përcaktuara me marrëveshjen për Ri-pranim të Komunitetit, refuzimet e aplikacioneve për ri-pranim vetëm mbi bazën e ofruar në Marrëveshjen për Ri-pranim të Komunitetit, pranimin e 'dokumentit të udhëtimit standard të BE-së për qëllime të dëbimit', pranimin e aplikacioneve për ri-pranim për shtetas të vendeve të treta/personave pa shtet.

## **B. MARRËVESHJA PËR LEHTËSIM TË VIZAVE:**

Republika e Kosovës të bashkëpunon ngushtë me Komisionin Evropian për mbështetjen e implementimit të Marrëveshjes për Lehtësim të Vizave nga ana e Shteteve Anëtare të BE-së, duke siguruar në veçanti monitorimin e vazhdueshëm të të gjitha institucioneve, autoriteteve dhe mekanizmave në Republikën e Kosovës të përfshirë në implementimin e kësaj Marrëveshje, lidhur me lëshimin e ftesave, çertifikatave dhe dokumenteve të tjera.

### **II. Kriteriumet mbi Sigurinë e Dokumenteve, Migrimit Ilegal, Rendit dhe Sigurisë Publike dhe Marrëdhënieve të Jashtme**

#### **BLLOKU 1: Siguria e Dokumenteve Pasaportat/dokumentet e udhëtimit, kartelave të identifikimit dhe dokumenteve shtesë:**

##### **Republika e Kosovës duhet të:**

- lëshon dokumente udhëtimi biometrike të lexueshme me makinë në përputhje me standardet e ICAO dhe KE-së dhe gradualisht të fut në përdorim të dhënat biometrike, përfshirë fotografinë dhe shenjat e gishtërinjëve;
- miraton dhe implementon masa adekuate administrative duke siguruar integritetin dhe sigurinë e procesit të personalizimit dhe shpërndarjes;
- krijimin e programeve trajnuese dhe miratimin e kodeve etike mbi anti-korrupsion dhe targetimin e zyrtarëve të çdo autoriteti publik që merret me viza apo pasaporta;
- raporton në bazën e të dhënave të Interpol/LASP mbi pasaportat e humbura dhe të vjedhura;
- siguron nivel të lartë të sigurisë së dokumenteve shtesë dhe kartelave të identifikimit dhe përkufizon procedura strikte që kanë të bëjnë me lëshimin e tyre.

#### **BLLOKU 2: Migrimi ilegal, përfshirë ri-pranimin Menaxhimi i kufirit**

##### **Republika e Kosovës duhet të:**

- miraton dhe implementon Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufinjëve Kombëtar me përgjegjësi të definuara në mënyrë të kurtë të menaxhimit të kufinjëve;
- miraton dhe implementon legjislacionin që rregullon lëvizjen e personave nëpër kufinjët e jashtëm, si dhe ligjin mbi organizimin e autoriteteve kufitare dhe funksionet e tyre në pajtueshmëri me Strategjinë e azhuruara të Menaxhimit të Integruar të Kufinjëve Kombëtar;

- ndërmarr masa të nevojshme buxhetore dhe të tjera administrative duke siguruar infrastrukturë efikase, pajisje, teknologji të IT-ës në kufinjët e jashtëm;
- krijon programe trajnimi dhe miraton kode etike mbi anti-korrupcion duke targetuar rojet kufitare, doganat dhe zyrtarët e tjerë të përfshirë në menaxhimin kufitar;
- përfundon një marrëveshje për punë me FRONTEX.

### **Përgjegjësitë e bartësit**

- Republika e Kosovës duhet të miraton dhe implementon legjislacionin mbi përgjegjësinë e bartësit duke përkufizuar sanksione.

### **Politika për azil**

#### **Republika e Kosovës duhet të:**

- implementon legjislacionin në fushën e azilit në linjë me standardet ndërkombëtare (Konventa e Gjenevës 1951 me Protokollin e Nju Jork-ut) dhe kornizën ligjore dhe standardet e BE-së;
- siguron infrastrukturë adekuate dhe forcon organet përgjegjëse, në veçanti në fushën e procedurave të azilit dhe pranimin e azil kërkuesve.

### **Menaxhimi i migracionit**

#### **Republika e Kosovës duhet të:**

- krijon dhe fillon të aplikon një mekanizëm monitorimi të rrjedhave të migracionit, definojnë profilin e migracionit që azhurohet në mënyrë të rregulltë për Republikën e Kosovës, me të dhëna edhe për migrimin ilegal ashtu edhe për migrimin legal dhe krijon organe përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi llojet dhe rrjedhat e migracionit;
- miraton dhe implementon politikën e integritit për migrantët përfshirë mbështetjen e qëndrueshme financiare dhe sociale;
- definojnë dhe aplikon një metodologji për zbulimin e brendshëm dhe të ndërmarr masa për përmirësimin e kapacitetit për hulumtimin e rasteve të migrimit të organizuar të mundësuar ilegal;
- implementon ligjin mbi pranimin dhe qëndrimin e shtetasve të vendeve të treat, duke definuuar të drejtat dhe obligimet për personat në fjalë (përfshirë anëtarët e familjeve të shtetasve të vendit të tretë);
- siguron dëbim efektivë të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht në territorin e saj.

### **Blloku 3: Rendi dhe siguria publike**

#### **Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit Republika e Kosovës duhet të:**

- miraton dhe implementon Strategjinë për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (në veçanti aspektet ndër kufitare) duke miratuar dhe implementuar planet e parapara të veprimit përfshirë kornizën kohore dhe resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
- miraton dhe implementon Strategjinë për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore duke miratuar dhe implementuar një Plan të Veprimit përfshirë kornizën kohore dhe resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
- miraton dhe implementon një strategji kombëtare për parandalimin dhe luftimin e shpërlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit, përfshirë masat e nevojshme legjislative bazuar në analizat e legjislacionit ekzistues; implementon legjislacionin përkatës mbi konfiskimin e asetëve të kriminelëve (përfshirë dispozitat që adresojnë aspekte ndër-kufitare);
- miraton dhe implementon një strategji kombëtare ndaj drogës dhe një plan kombëtar të veprimit ndaj drogës; bërjen e informatave mbi konfiskimet e drogës dhe personave të përfshirë të arritshme në pikat e kalimeve kufitare; mëtej të zhvillon bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave me organet relevante ndërkombëtare në fushën e drogës;
- miraton dhe implementon Strategjinë Kombëtare Anti-Korrupsion gjithëpërfshirëse me miratimin dhe implementimin e Planit të Veprimit; miratimin dhe implementimin e masave për forcimin e kapacitetit institucional, koordinimin ndër-sektorial dhe që ofrojnë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për përpjekjet anti-korrupsion;
- implementon konventat relevante të KB-ës dhe të Këshillit të Evropës, si dhe rekomandimet e GRECO dhe standardet tjera ndërkombëtare në fushat e renditura më lartë dhe për luftën kundër terrorizmit.

#### **Bashkëpunimi juridik mbi çështjet kriminale**

##### **Republika e Kosovës duhet të:**

- implementon konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet kriminale (në veçanti Konventat e Këshillit të Evropës);
- ndër marr masa me synim përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet kriminale të gjykatësve dhe prokurorëve me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me vendet në rajon;
- zhvillon marrëdhënie të punës me Eurojust kryesisht përmes pikës së kontaktit në Eurojust.

## **Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit**

### **Republika e Kosovës duhet të:**

- ndërmarr hapat e nevojshëm për të siguruar efikasitet në bashkëpunimin për zbatimin e ligjit në mes agjencive kombëtare relevante – posaqërisht rojeve kufitare, policisë, zyrtarëve doganor përmes bashkëpunimit të plotë ndër-sektorial në fushën e shkëmbimit të intelegjencës -, si dhe bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore;
- përmirëson këmbimin e informatave në mes të agjencive kombëtare duke krijuar mekanizma adekuat dhe efektivë për koordinim;
- zhvillon bashkëpunimin rajonal të shërbimeve për zbatim të ligjit dhe implementon marrëveshje bilaterale dhe multilaterale operacionale bashkëpunimi, përfshirë këmbimin e informatave përkatëse me kohë me autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit të Shteteve Anëtare;
- përmirëson kapacitetet operacionale dhe special hetimore të shërbimeve të zbatimit të ligjit për trajtim (prekje) në mënyrë më efikase të krimin ndërkufitar;
- ndërmarr hapat e nevojshëm për përgatitjen e përfundimit (lidhjes) të një marrëveshje operacionale bashkëpunimi me Europol me theks special në dispozitat për mbrojtjen e të dhënave.

### **Mbrojtjen e të dhënave**

#### **Republika e Kosovës duhet të:**

- miraton legjislacionin e nevojshëm mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe implementon dispozitat e saj përfshirë krijimin e një autoriteti mbikëqyrës të pavarur për mbrojtjen e të dhënave;
- ratifikon dhe implementon konventat përkatëse ndërkombëtare, si Protokollin Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procesimin Automatik të të Dhënave Personale.

## **BLLOKU 4: Marrëdhëniet e Jashtme dhe të Drejtat Themelore**

### **Liria e lëvizjes së shtetasve të Republikës së Kosovës**

#### **Republika e Kosovës duhet të:**

- siguron se liria e lëvizjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk u nënshtrohet kufizimeve të pajustificueshe, përfshirë masat e natyrës diskriminuese, bazuar në çfarëdo baze të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tipareve gjenetike, gjuhës, religjionit apo besimit, mendimit politik apo ndonjë tjetër, anëtarë i një pakice kombëtare, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, moshës apo orientimit seksual .

## **Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit**

### **Republika e Kosovës duhet të:**

- siguron qasje të plotë dhe efektive në dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit për të gjithë qytetarët e Kosovës përfshirë gratë, fëmijët, njerëzit me paaftësi, njerëzit që i përkasin minoriteteve dhe grupeve tjera të ndieshme;
- siguron qasje të plotë dhe efektive për dokumentet e identitetit për IDP dhe refugjatë.

### **Të drejtat e qytetarëve përfshirë mbrojtjen e minoriteteve**

#### **Republika e Kosovës duhet të:**

- miraton dhe zbaton legjislacionin për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit;
- specifikon kushtet dhe rrethanat për fitimin e nënshtetësisë së Kosovës;
- siguron hetimin e incidenteve të motivuara etnikisht nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fushën e lirisë së lëvizjes, erfshirë rastet e targetimit të anëtarëve të minoriteteve;
- siguron që dispozitat kushtetuese mbi mbrojtjen e minoriteteve zbatohen
- implementon politikat përkatëse lidhur me minoritetet, përfshirë romët.

### ***Shënimi përfundimtar***

Udhërrëfyeni i tanishëm përfshin listën e masave që do të ndërmerren nga Republika e Kosovës me synim të heqjes së detyrimit për vizë. Këto masa synojnë tu përgjigjen nevojave të identifikuar, bazuar në informatat e tanishme në dispozicion. Në rast të ndryshimeve substanciale të situatës aktuale, Komisioni mund të propozon rishikimin dhe ri-përshtatjen e udhërrëfyesit.

Bazuar në arritjet e Republikës së Kosovës të implementimit të kriterëve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes, Komisioni do të vlerëson situatën, duke marr parasysh në mes tjerash kriteret të tilla si shkalla e refuzimit të aplikuesve për vizë dhe shkalla e refuzimit të hyrjes në zonën e përbashkët të Schengen-it për shtetasit e Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, trendi ulës i shkallës së refuzimit, që do të duhej të përparonte drejt 3% për viza dhe 1000 persona në vit të refuzuar për hyrjen në zonën e përbashkët të Schengen-it, do të përdoret si referencë indikative.

Republika e Kosovës duhet gjithashtu të marr masa të nevojshme për të mundësuar implementim efikas të veprimeve të përbashkëta të BE-së mbi ndalesën e udhëtimit. Si u përmend tashmë më herët, mbi këtë bazë Komisioni do të shqyrton mundësinë për t'ia paraqitur propozimin Këshillit për heqjen e detyrimit të vizës, duke amandamentuar Rregulloren e Këshillit 539/2001 dhe

duke ndjekur procedurën e parashtruar në Traktatin e KE-së për këto çështje, Këshilli në bazë të propozimit të Komisionit, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, do të marr vendim duke vepruar sipas shumicës së përshtatshme. Amandamenti i tillë do të mund të mbulonte shpejtë poseduesit e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara në pajtim me standardet e ICAO dhe KE-së.